



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I.Numër:320/01-000058, datë: 28. Dhjetor 2020.

Në bazë të nenit 11, nenit 12.2. shkronja d) dhe nenit 17 paragrafi 1 shkronja s) Nr.03/L – 040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28.datë: 04. Qershor 2008”), nenit 3 paragrafi 1 pika 1.1, nenit 49 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 52 paragrafi 1.5 dhe nenit 53. paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 20/21 qershor 2016”), nenit 13 paragrafi 1. pika 1.20, dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4, të Statutit të Komunës së PejësI.Numër:01-016/01-413431 dt. 30. Shtator 2020, dhe bazuar në vlerësimin Nr. 4486 dt. 23.11.2020, të Departamentit ligjor të MBPZHR-al, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 28. Dhjetor 2020, muarr:

V E N D I M

Nr. 69/2020

mbi Anulimin e Vendimit Nr. 52/2020, të datës 30. Tetor 2020, me numër të referencës I.Numër:01/320/01-92208, të Kuvendit Komunal Pejë

1. Me këtë vendim **ANULOHET** Vendimi Nr. 52/2020 i datës 30. Tetor 2020, me numër të referencës I.Numër: 01/320/01-92208 i Kuvendit Komunal Pejë mbi themelimin e vendgjutive në Komunën e Pejës, për arsye se paraprakisht nuk është kërkuar e as që është siguruar pëlqimi nga MBPZHR-al, për themelimin e vendgjutive, konform dispozitave të nenit 19, paragrafi 19.2 të Ligjit Nr. 02/L-53 për Gjuetinë (“Gazeta zyrtare e republikës së Kosovës, Nr. 8 dt. 01.Janar 2007”).
2. Për Zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës së Pejës në bashkëpunim me Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi të KK. Pejë.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi ti dërgohet:

- 1x1. MPL-së.
- 1x1. Kryetarit të Komunës dhe DBPH.
- 1x1. Arkivë.



KRYESUESI I KUVENDIT,

Dr. Islam Husaj